

20160270722

L I G J I
PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT PËR TË DREJTËN E AUTORIT
DHE TË DREJTA TË PËRAFËRTA

Neni 1

Në Ligjin për të drejtën e autorit dhe të drejta të përafërta ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 115/10, 51/11, 147/13 dhe 154/15), në nenin 130 paragrafi (2) ndryshohet si vijon:

"(2) Menaxhimi kolektiv mund të realizohet edhe për të drejta të jashtëzakonshme që realizohen individualisht, nëse me marrëveshjen kjo e drejtë i është bartur në organizim për menaxhim kolektiv nga autori përkatësisht bartësi i të drejtës."

Pas paragrafit (2) shtohet paragraf i ri (3), si vijon:

"(3) Autori përkatësisht bartësi i të drejtës mundet me deklaratë për marrjen (ndalimin) e menaxhimit kolektiv të vërtetuar në noter të dorëzuar në organizatën për menaxhim kolektiv të ndalojë organizim të menaxhimit kolektiv që ta menaxhojë të drejtën e tij."

Neni 2

Në nenin 135 paragrafi (1) fjalët: "pikat 1 dhe 6" zëvendësohen me fjalët: "pikat 1, 3, 4, 5 dhe 8".

Pas paragrafit (1) shtohet paragraf i ri (2), si vijon:

"(2) Organizatat radiotelevizive në rastet e nenit 137 pikat 3, 4 dhe 5 të këtij ligji, para fillimit me kryerjen e veprimtarisë, përkatësisht emetimin e programit i cili përmban vepra të autorit përkatësisht lëndë të drejtave të përafërta janë të obliguar të kërkojnë leje nga organizata për menaxhim kolektiv."

Paragrafët (2) dhe (3) bëhen paragrafë (3) dhe (4).

Pas paragrafit (4) i cili bëhet paragraf (5) shtohen tre paragrafë të rinj (6), (7) dhe (8), si vijojnë:

"(6) Me përjashtim të paragrafit (5) të këtij neni, në rastet kur sistemi për evidencë elektronike nuk është i instaluar për shkak të asaj që organizata -radio-televizive nuk e ka mundësuar instalimin e sistemit, si dhe në rast të ndërprerjes së punës së sistemit për evidencë elektronike që nuk ka qenë e nxitur nga organizata për menaxhim kolektiv, organizata radio-televizive është e obliguar në afat prej 30 ditësh nga dita e ndërprerjes së punës së sistemit për evidencë elektronike deri te organizata për menaxhim elektronik ta dorëzojë në formë elektronike datotekën ditore të veprave të autorit përkatësisht lëndë të drejtave të përafërta të emituar në programin e organizatës radio-televizive.

(7) Me marrëveshjen e lidhur me organizatës për menaxhim kolektiv dhe organizatës radio-televizive mund të konstatohen edhe forma të tjera të ndryshme nga forma e përcaktuar në paragrafin (6) të këtij neni në dorëzimin e të dhënave për emetimin e të drejtave të autorit përkatësisht lëndë të drejtave të përafërta.

(8) Në rastin nga paragrafi (6) i këtij neni, në afat prej më së shumti 60 ditë nga dita e ndërprerjes në punën e sistemit për evidencë elektronike, organizata e menaxhimit kolektiv mund të kërkojë edhe nga Agjencia për Shërbime Mediale Audio dhe Audiovizuale që t'ia dorëzojë evidencën e programit të emituar në organizatën radio-televizive në formën dhe në mënyrën e përcaktuar me dispozitat me të cilat rregullohet kryerja e shërbimeve audio dhe audiovizuale."

Paragrafët (5), (6) dhe (7) bëhen paragrafët (9), (10) dhe (11).

Neni 3

Neni 135-a ndryshohet si vijon:

"(1) Për shkak të evidentimit elektronik përpunimi i të dhënave, përcjellja dhe kontrolli mbi emetimin e të drejtave të autorit, përkatësisht lëndët e të drejtave të përafërta, organizatat për menaxhim kolektiv janë të obliguar të sigurojnë dhe të instalojnë sistem të organizatës radio-televizive për evidentim elektronik të veprave të autorit, përkatësisht lëndë të drejtave të përafërta (në tekstin e mëtejshëm: sistemi për evidencë elektronike).

(2) Sistemi për evidencë elektronike është vendim i integruar informatik komunikues me sistem të siguruar të mbrojtjes përmes të cilit bëhet evidentimi elektronik, përpunimi i të dhënave, përcjellja dhe kontrolli mbi veprat e emetuara të autorit përkatësisht lëndë të drejtave të përafërta.

(3) Organizatat radio-televizive janë të obliguara të sigurojnë sistem kompatibil me të cilin mundësohet përfshirje në sistemin për evidencë elektronike dhe të mundësojnë organizatave për evidencë elektronike dhe t'i mundësojnë organizatave për menaxhim kolektiv instalimin e sistemit për evidencë elektronike.

(4) Organizata për menaxhim kolektiv dhe organizata radio-televizive të cilat është i instaluar sistemi për evidencë elektronike janë të obliguar ta mbajnë në përdorim sistemin për evidencë elektronike.

(5) Të drejtat e ndërsjella dhe obligimet e organizatës për menaxhim kolektiv dhe organizatat radio-televizive në mirëmbajtjen në përdorimin e sistemit për evidencë elektronike mund të rregullohen edhe me marrëveshje të ndërsjellë, në pajtim me këtë ligj.

(6) Sistemi për evidencë elektronike siguron në veçanti:

- Identifikimin e veprave të emetuara të të drejtave të autorit përkatësisht lëndëve të të drejtave të ngjashme në kohën kur ato emitohen në programin e organizatës radio-televizive, me shmangie të lejuar kohore në pajtim me nenin 135-d paragrafi (2) të këtij ligji;

- incizime nga veprat e emetuara të autorit përkatësisht lëndët e të drejtave të përafërta;

- raporte ditore, mujore dhe vjetore dhe raporte të tjera periodike për veprat e emetuara të autorit përkatësisht lëndë të drejtave të përafërta për parametra të caktuar (numri i veprave të autorit, përkatësisht lëndë të drejtave të përafërta, periudha kohore të emetimit, kohëzgjatja e emetimit, identifikimi i organizatave radiodifuzive në të cilën është emituar vepra, raport ditor për organizata radio-difuzive të cilat evidentojnë të dhëna për veprat e emetuara të autorit përkatësisht lëndë të drejtave të përafërta në sistemin e evidencës elektronike);

- njoftim përmes rrugës elektronike të personi i organizatës për menaxhim kolektiv dhe personi në organizatën radio-televizive për ndërprerjen në punën e sistemit për evidencë elektronike dhe

- ruajtjen e të dhënave nga sistemi për evidencë elektronike në afat prej pesë vitesh nga dita e evidentimit të tyre."

Neni 4

Pas nenit 135 -a shtohen katër tituj të rinj dhe katër nene të reja 135-b, 135-v, 135-g dhe 135-d, si vijojnë:

"Leja për përdorimin e sistemit për evidencë elektronike

Neni 135-b

(1) Leje për përdorimin e sistemit për evidencë elektronike, me kërkesë të organizatës për menaxhim kolektiv lëshon Ministria e Shoqërisë Informatike dhe Administratës me mendim paraprak nga Ministria e Kulturës.

(2) Nëse Ministria e Kulturës ka lëshuar leje për menaxhim kolektiv të dy ose më shumë organizatave për menaxhim elektronik me llojin e njëjtë të drejtave, të cilat përfshijnë edhe grumbullimin e kompensimeve nga emetimi radiodifuziv i të drejtave të autorit ose lëndë të drejtave të përafërta, organizatat janë të obliguara deri në 60 ditë nga lëshimi i lejes së fundit për menaxhim kolektiv, të lidhin marrëveshje me të cilën do ta rregullojnë mënyrën e sigurimit të përbashkët dhe instalimin e sistemit për evidencë elektronike.

(3) Me marrëveshjen nga paragrafi (2) i këtij neni rregullohen të drejtat e ndërsjella dhe obligimet e organizatave, në veçanti pjesëmarrje të barabartë në çdo organizatë në harxhimet për sigurim, instalim dhe mirëmbajtje të sistemit për evidencë elektronike, krijimin e datotekës së të dhënave të veprave të autorit përkatësisht lëndë të drejtave të përafërta dhe çështje tjera lidhur me funksionimin e sistemit për evidencë elektronike.

(4) Organizatat nga paragrafi (2) i këtij neni janë të obliguara në afat prej pesë ditëve nga dita e lidhjes së marrëveshjes nga paragrafi (2) i këtij neni, marrëveshjen ta dorëzojnë në Ministrinë e Kulturës.

(5) Nëse në afat prej 60 ditësh nga dita e lëshimit të lejes nga paragrafi (2) i këtij neni, organizatat nuk e lidhin marrëveshjen nga paragrafi (2) i këtij neni, Ministria e Shoqërisë Informatike dhe Administratës në bashkëpunim me Komisionin për Ndërmjetësim në të Drejtën e Autorit dhe të Drejtat e Ngjashme, me kërkesë të Ministrisë së Kulturës, në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimi të kërkesës do të japë mendim për lëndën e mospajtimit të organizatave.

(6) Organizatat nga paragrafi (2) i këtij neni në afat prej 30 ditëve nga dita e dorëzimit të mendimit nga paragrafi (5) i këtij neni janë të obliguara ta lidhin marrëveshjen nga paragrafi (2) i këtij neni në pajtim me mendimin e Ministrisë së Shoqërisë Informatike dhe Administratës.

(7) Nëse organizatat nga paragrafi (2) i këtij neni nuk e lidhin marrëveshjen nga paragrafi (2) i këtij neni në afatin e paragrafit (6) të këtij neni, Ministria e Kulturës në afat prej 15 ditësh do të miratojë aktvendim për marrjen e lejes së organizatave nga paragrafi (2) i këtij neni.

(8) Në rast të paragrafit (2) të këtij neni, Ministria e Shoqërisë Informatike dhe Administratës me mendim paraprak të Ministria e Kulturës do të japë pëlqim për përdorimin e përbashkët të sistemit për evidencë elektronike.

(9) Kërkesa nga paragrafi (1) i këtij neni dorëzohet në pajtim me Ligjin për procedurë të përgjithshëm administrative.

(10) Formën dhe përmbajtjen e formularit të kërkesës nga paragrafi (1) i këtij neni i përcakton ministri i Kulturës.

Të drejta dhe obligime të organizatës për menaxhim kolektiv për mbajtjen e sistemit për evidencë elektronike

Neni 135-v

(1) Organizatat për menaxhim kolektiv janë të obliguara të emërojnë person për përcjelljen e punës së sistemit për evidencë elektronike.

(2) Në rastet nga neni 135-b paragrafi (2) të këtij ligji, organizatat për menaxhim kolektiv bashkërisht e emërtojnë personin nga paragrafi (1) i këtij neni.

(3) Personi nga paragrafi (1) i këtij neni është i obliguar ta kontrollojë kompatibilitetin e sistemit të organizatës radio-televizionit për shkak të instalimit të sistemit për evidencë elektronike, ta instalojë sistemin për evidencë elektronike te organizatat radio-televizive, ta mbajë në punë dhe ta përcjellë punën e sistemit për evidencë elektronike.

(4) Në rast të ndërprerjes së punës së sistemit për evidencë elektronike personi nga paragrafi (1) i këtij neni është i obliguar, menjëherë të marrë masa për mënjanimin e shkaqeve të cilat kanë sjellë ndërprerjen e punës së sistemit.

(5) Nëse ndërprerja e punës së sistemit për evidencë elektronike është shkaktuar nga pengesat në punën e sistemit kompjuterik në organizatën e radio-televizionit, personi nga paragrafi (1) i këtij neni është i obliguar në afat prej tri orëve nga fillimi i ndërprerjes së punës së sistemit të evidencës elektronike me shkrim, postë elektronike ose telefon ta informojë organizatën e radio-televizionit dhe japë mendime për mënjanimin e pengesave në punën e sistemit ose drejtpërdrejtë në hapësirat e organizatës së radio-televizionit t'i mënjanojë pengesat në sistemin kompjuterik. Për veprimet e marra për mënjanimin e pengesave në punën e sistemit për evidencë elektronike është i obliguar të dorëzojë procesverbal.

(6) Organizatat për menaxhim kolektiv janë të obliguar që t'u mundësojnë autorëve, përkatësisht bartësve të të drejtave të përafërta kontroll të të dhënave nga sistemi për evidencë elektronike të cilat kanë të bëjnë me emetimin e tyre të drejtave të autorit përkatësisht lëndë të drejtave të përafërta.

(7) Organizatat për menaxhim kolektiv janë të obliguara që t'i mundësojnë autoreve, përkatësisht bartësve të të drejtave të përafërta kontroll të të dhënave nga sistemi për evidence elektronike të cilat kanë të bëjnë me programin e tyre të emetuar ku përmbahen të drejtat e autorit, përkatësisht lëndë të drejtave të përafërta.

(8) Kontrolli nga paragrafët (6) dhe (7) të këtij neni mundësohet përmes llogarisë së veçantë të shfrytëzuesit me emrin dhe fjalëkalimin e shfrytëzuesit.

Të drejta dhe obligime të organizatës radio-televizive për mirëmbajtjen e sistemit për evidence elektronike

Neni 135-g

(1) Organizata radio-televizive është e detyruar të emërojë person për përcjelljen e punës së sistemit për evidencë elektronike në organizatën radio-televizive.

(2) Personi nga paragrafi (1) i këtij neni është i obliguar ta përcjellë punën e sistemit për evidencë elektronike dhe ta mbajë sistemin e instaluar në organizatën radio-televizive në komunikim me sistemin për evidencë elektronike në organizim të menaxhimit kolektiv.

(3) Nëse personi nga paragrafi (1) i këtij neni e vërteton se organizata radio-televizive për evidencë elektronike nuk funksionin është e obliguar menjëherë të marrë masa për mënjanimin e pengesave në punën e sistemit dhe ta informojë personin nga neni 135-v paragrafi (1) të këtij ligji.

(4) Personi nga paragrafi (1) i këtij neni është i obliguar të veprojë sipas udhëzimeve për mënjanimin e pengesave në punë në sistemin kompjuterik në organizatën e radio-televizionit të dhëna nga personi nga neni 135-v paragrafi (1) të këtij ligji dhe t'i lejojë qasje në sistemin kompjuterik të organizatës së radio-televizionit.

Mbikëqyrja mbi punën e sistemit për evidencë elektronike

Neni 135-d

(1) Ministria e Shoqërisë Informatike dhe Administratës kryen mbikëqyrje teknike mbi punën e sistemit për evidencë elektronike në pajtim me nenet 135-a, 135-b, 135-v dhe 135-g të këtij ligji.

(2) Përshkrimin dhe karakteristikat teknike të sistemit për evidencë elektronike, shërbimet të cilat i siguron, masat për sigurim mbrojtje, kushtet minimale të cilat duhet t'i plotësojë organizata radio-televizive për shkak të sigurimit të kompatibilitetit me sistemin për evidencë elektronike dhe çështje të tjera me rëndësi për punën e sistemit i përcakton ministri i kulturës, në pajtim me ministrin e shoqërisë informatike dhe administratës."

Neni 5

Në nenin 137 paragrafi (1) pikat 3), 4) dhe 5), ndryshohen si vijojnë:

"3) kur shfrytëzimi i veprës së autorit, përkatësisht lëndës së të drejtave të përafërta bëhet nga ana e organizatës radio-televizive në të cilën është i instaluar sistemi për evidencë elektronike, kompensimi për shfrytëzim përcaktohet në shumë nominale e cila vlerësohet varësisht nga kohëzgjatja e emitimit, përkatësisht shfrytëzimi i evidentuar në sistemin e evidencës elektronike.

4) kur shfrytëzuesi i veprës së autorit, përkatësisht lënda e të drejtave të përafërta bëhet nga ana e organizatës radio-televizive në të cilën nuk është i instaluar sistemi për evidencë elektronike, kompensimi për shfrytëzim përcaktohet në procesin nga të hyrat të cilat i përfshin

mjetet nga taksa radiodufuzive ose pagesa të reklamave, sponsorëve dhe të hyrave nga qarkullimi i programeve. Sikur të hyra nuk llogariten mjetet nga tatimi mbi vlerën e shtuar, mjetet nga kreditë dhe kamatat e kredive.

5) Organizata për menaxhim kolektiv dhe organizata radio-televizive në rast të pikës 3) të këtij paragrafi me kërkesë të organizatës radio-televizive me marrëveshje mund të konfirmojnë kompensim për shfrytëzimin e veprës së autorit përkatësisht lëndës së të drejtës së përafërt që të përcaktohet në përqindje nga e hyra në pajtim me pikën 4) të këtij paragrafi".

Pika 7) shlyhet.

Pikat 8) dhe 9) bëhet pika 7) dhe 8).

Në pikën 10) e cila bëhet pika 9) fjalët: "pikat 1, 2, 3 dhe 6" zëvendësohen me fjalët: "pikat 1, 2, 3, 4, 5 dhe 8".

Pika 11) bëhet pika 10).

Në pikën 12) e cila bëhet pika 11) fjalët: "nga pika 11)" zëvendësohen me fjalët: "nga pika 10)".

Neni 6

Në nenin 141 paragrafi (1) fjalët: "nenet 140 dhe 140-a" zëvendësohen me fjalët: "nenet 135-b paragrafi (5), 140 dhe 140-a".

Neni 7

Në nenin 144 paragrafët (4) dhe (5) ndryshohen si vijojnë:

"(4) Mjetet e organizatës të realizuara nga kamata e mjeteve të investuara në bankë dhe të hyra të tjera, në shumë prej 30% shpërndahen mes autorëve përkatësisht bartësve të drejtave të përafërta, në mënyrë të barabartë të pagesës së kompensimeve që ata i kanë realizuar në pajtim me të dhënat e veprave të shfrytëzuara nga neni 135 paragrafi (1) i këtij ligji, ndërsa shuma prej 70% shpërndahet mes autorëve përkatësisht bartësve të drejtave të përafërta, në pajtim me të dhënat e veprave të shfrytëzuara për evidencë elektronike, përkatësisht në pajtim me të dhënat e nenit 135 paragrafët (6) dhe (7) të këtij ligji.

(5) Mjetet të cilat organizata i siguron nga shfrytëzuesit, ndërsa janë të vlerësuara në shuma paushall dhe mjetet të cilat organizata i grumbullon nga riemitmi kabllorik vepra të autorit dhe lëndë të drejtave të përafërta, shpërndahet mes autoreve përkatësisht bartësve të drejtave të përafërta në mënyrë të barabartë të pagimit të kompensimit që ata e kanë realizuar në pajtim me të dhënat e shfrytëzuesve për vepra të shfrytëzuara nga sistemi për evidencë elektronike përkatësisht në pajtim me të dhënat e nenit 135 paragrafët (6) dhe (7) të këtij ligji."

Neni 8

Në nenin 146 pas paragrafit (1) shtohen dy paragrafë të rinj (2) dhe (3), si vijojnë:

"(2) Kërkesa nga paragrafi (1) i këtij neni dorëzohet në pajtim me Ligjin për procedurë të përgjithshme administrative.

(3) Formën dhe përmbajtjen e formularit të kërkesës nga paragrafi (1) i këtij neni e përcakton ministri i Kulturës".

Paragrafi (2) i cili bëhet paragraf (4) ndryshohet si vijon:

"(4) Me kërkesës nga paragrafi (1) i këtij neni organizata dorëzon statut, përkatësisht marrëveshje për themelim dhe dokumentacion tjetër të përcaktuar me këtë ligj, ndërsa vendimin për regjistrim në Regjistrin Qendror të Republikës së Maqedonisë e siguron Ministria e Kulturës me detyrë zyrtare."

Në paragrafin (3) i cili bëhet paragraf (5) fjalët: "paragrafi (2)" zëvendësohen me fjalët: "paragrafi (4)".

Neni 9

Në nenin 150 paragrafi (3) pas fjalës "ligj" pika zëvendësohet me presje dhe shtohen fjalët: "në procedurë dhe në mënyrë të përcaktuar në nenin 135-b të këtij ligji."

Neni 10

Titulli në nenin 151-a dhe neni 151-a shlyhen.

Neni 11

Në nenin 157 pas paragrafit (2) shtohet paragraf i ri (3), si vijon:

"(3) Nëse në zbatimin e mbikëqyrjes mbi punën e organizatës, Ministria e Kulturës përcakton se organizata nga mjetet e grumbulluara në bazë të kompensimeve, për harxhime në punën e organizatës ka harxhuar shumë më të madhe nga shuma e maksimumit të përcaktuar me ligj, Ministria e Kulturës do të japë vendim për marrjen e lejes për menaxhim kolektiv."

Paragrafi (3) i cili behët paragraf (4) ndryshohet si vijon:

""(4) Kundër vendimit për marrjen e lejes nga paragrafët (2) dhe (3) të këtij neni mund të ngritët kontest administrativ para gjykatës kompetente."

Neni 12

Në nenin 182 paragrafi (1) alineja 2 fjalët: "neni 135 paragrafët (1), (2) dhe (3)" zëvendësohen me fjalët: "neni 135 paragrafët (1), (2) (3), (4), (5), (6) dhe (7)."

Në alinenë 3 fjalët: "neni 135 paragrafi (5)" zëvendësohen me fjalët: "neni 135 paragrafi (9)".

Neni 13

Pas nenit 183 shtohet neni i ri 183-a, si vijon:

"Neni 183-a

(1) Gjobë në shumë prej 3000 eurosh në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet si kundërvajtje organizatës radio-televizive nëse:

1) nuk emërton person për përcjelljen e punës së sistemit të evidencës elektronike (neni 135-g paragrafi (1));

2) nuk e përcjellë punën dhe nuk e mban sistemin e instaluar në organizatën radio-televizive në komunikim me sistemin për evidence elektronike në organizim të evidencës elektronike (neni 135-g paragrafi (2));

3) nuk ndërmerr masa për mënjanimin e pengesave në punën e sistemit dhe nuk e informon organizatën për menaxhim kolektiv për pengimin në punën e sistemit kompjuterik në organizatën radio-televizive (neni 135-g paragrafi (3)); dhe

4) nuk vepron sipas udhëzimeve të organizatës për menaxhim kolektiv për mënjanimin e pengesave në punën ose nuk mundëson qasje në lokalet e organizatës së radio-televizionit (neni 135 paragrafi (4)).

(2) Gjobë në shumë prej 30% nga gjoba e përcaktuar për personin juridik do t'i shqiptohet për kundërvajtje nga paragrafi (1) i këtij neni personit përgjegjës në personin juridik."

Neni 14

Pas nenit 185 shtohet neni i ri 185-a, si vijon:

"Neni 185-a

(1) Gjobë me shumë prej 3000 euro në kundërvlere me denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje organizatës radio-televizive nëse:

1) nuk emëron person për përcjelljen e punës së sistemit të evidencës elektronike (neni 135-v paragrafi (1));

2) nuk ndërmerr masa për mënjanimin e pengesave në funksionimin e sistemit për evidentim elektronik (neni 135-v paragrafi (4));

3) nuk e informon organizatën radio-televizive për pengesat në punën e sistemit kompjuterik në organizatën radio-televizive, nuk jep udhëzime në organizatën radio-televizive për mënjanimin e pengesave në punën ose nuk ka qasje në lokalet e organizatës radio-televizive me qëllim të mënjimit të pengesave në punën e sistemit për evidencë elektronike. (neni 135-v paragrafi (5)); dhe

4) nuk mundëson kontroll në të drejtat ose te bartësit e të drejtave të përafërta, përkatësisht organizatat radio-televizive në të dhënat e sistemit për evidencë elektronike (neni 135-v paragrafët (6) dhe (7)).

(2) Gjobë me shume prej 30% nga gjoba e përcaktuar për personin juridik do t'i shqiptohet për kundërvajtje nga paragrafi (1) i këtij neni personit përgjegjës në personin juridik." .

Neni 15

(1) Procedurat për miratimin e tarifave të organizatave për menaxhim kolektiv, të filluara para ditës së hyrjes në fuqi të këtij ligji, do të vazhdojnë sipas dispozitave të këtij ligji.

Neni 16

Organizatat radiotelevizive të cilat në ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji kryejnë veprimtari, përkatësisht emitim të programit i cili mban të drejta të autorit përkatësisht lëndë të drejtave të përafërta nga organizata për menaxhim kolektiv do të kërkojnë leje për shfrytëzimin e të drejtave të autorit dhe lëndë të drejtave të përafërta në afat prej 30 ditësh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 17

Organizatat për menaxhim kolektiv të cilat kanë marrë leje për përdorimin e sistemit për evidencë elektronike do ta harmonizojnë punën e sistemit për evidencë elektronike me dispozitat e këtij ligji në afat prej katër muajve nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 18

(1) Organizatat për menaxhim kolektiv do ta emërtojnë personin nga neni 4 i këtij ligji me të cilin të shtohet neni i ri 135-v paragrafi (1), në afat prej katër muajve nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

(2) Organizatat për menaxhim kolektiv do ta emërtojnë personin nga neni 4 i këtij ligji me të cilin do të shtohet neni i ri 135-g paragrafi (1), në afat prej katër muajsh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 19

Aktet nënligjore të parapara me këtë ligj do të miratohen në afat prej gjashtë muajsh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 20

Dispozitat nga neni 4 i këtij ligji me të cilin shtohet neni i ri 135-b paragrafi (9) dhe neni 8 i këtij ligji me të cilin në nenin 146 shtohen paragrafët (2), (3) dhe (4), do të fillojnë të zbatohen me fillimin e zbatimit të Ligjit për procedurë të përgjithshme administrative, në pajtim me nenin 141 të Ligjit për procedurë të përgjithshme administrative ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 124/15).

Neni 21

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë".